

# PAZARET ME PATRIARKATIN

nga Deniz Kandiyoti

Përktheu në shqip: Kolektivi për Mendim dhe Veprim Feminist

*Ky artikull argumenton se analizat sistematike krahasuese të strategjive dhe mekanizmave mbrojtës të grave çojnë drejt të kuptuarit të sistemeve patriarkale të bazuar më shumë në kulturë dhe kohë specifike sesa nocioni i pakualifikuar dhe abstrakt i patriarkatit që haset në teorinë bashkëkohore feministe. Gratë hartojnë strategji brenda disa kufizimeve konkrete, të cilat unë i identifikoj si pazare patriarkale. Format e ndryshme të patriarkatit iu prezantojnë grave "rregulla të veçanta të lojës" dhe kësisoji bëjnë thirrje për strategji të ndryshme për ta maksimizuar sigurinë dhe optimizuar opsionet e jetës me potencial të ndryshueshëm për rezistencë aktive ose pasive përballë shtypjes. Dy sisteme të dominimit mashkullor do të krahasohen: modeli i Afrikës sub-sahariane, në të cilin pasiguritë e poligjinisë përputhen me zonat e autonomisë relative për gratë dhe patriarkati klasik, i cili është karakteristik për Azinë Jugore dhe Lindore si dhe për Lindjen e Mesme Muslimane. Artikulli përfundon me një analizë të kushteve që çojnë në shkatërrimin dhe transformimin e pazareve patriarkale dhe implikimet e tyre në vetëdijen dhe betejat e grave.*

Nga të gjitha konceptet e prodhuara nga teoria bashkëkohore feministe, patriarkati është me siguri koncepti më i përdoruri dhe në disa aspekte, më pak i teorizuar. Kjo gjendje nuk është për shkak të neglizhencës, pasi ka një vëllim të konsiderueshëm shkrimesh mbi këtë çështje por më tepër për shkak të kushteve specifike të zhvillimit të përdorimeve feministe bashkëkohore të termit. Përderisa feministet radikale inkurajojnë një përdorim tejet radikal të konceptit, të aplikueshëm ndaj çdo forme apo instance të dominimit mashkullor, feministet socialiste kryesisht e kufizojnë veten në përdorimin e konceptit për të analizuar lidhjen mes patriarkatit dhe klasës nën kapitalizëm. Si rezultat, termi patriarkat shpesh çonë tek një konceptim tejet monolit të dominimit mashkullor, i cili trajtohet në një nivel abstraksioni që më tepër errëson sesa që shpërfaqë çështjet e brendshme e intime të marrëveshjeve të veçanta kulturore dhe historike midis gjinive.

Nuk është qëllimi im të rishqyrtoj debatet teorike rreth patriarkatit (Barrett 1980; Beechey 1979; Delphy 1977; Eisenstein 1978; Hartmann 1981; McDonough dhe Harrison 1978; Mies 1986; Mitchell 1973; Young 1981). Në vend të kësaj, do të doja të propozoja një pikë hyrëse të rëndësishme dhe relativisht të neglizhuar për identifikimin e formave të ndryshme të patriarkatit, përmes një analize të strategjive të grave për t'u ballafaquar me to. Unë do të argumentoj se gratë zhvillojnë strategji brenda një sërë kufizimesh konkrete që zbulojnë dhe definojnë planin e asaj që unë do ta quaj si "pazari patriarkal" i çdo shoqërie, i cili mund të shfaqet në variacione të ndryshme në bazë të klasës, kastës dhe përkatësisë etnike të grave. Këto pazare patriarkale kanë ndikim të madh në formësimin e subjektivitetit gjinor të grave dhe përcaktojnë natyrën e ideologjisë gjinore brenda konteksteve të ndryshme. Po ashtu, pazaret patriarkale e ndikojnë potencialin për rezistencë aktive ose pasive të grave përballë shtypjes së tyre dhe formës specifike që ato mund të marrin. Për më tepër, pazaret patriarkale nuk janë entitete të përhjetshme ose të pandryshueshme por janë të ndjeshme ndaj transformimeve historike të cilat hapin fusha të reja të luftës dhe rinegocimit të marrëdhënieve ndërmjet gjinive.

Për ilustrim, do të krahasoj dy sisteme të dominimit mashkullor, të paraqitura si sisteme ideale-tipike me qëllim të diskutimit të implikimeve të tyre për gratë. Unë do t'i përdori këto lloje ideale si pajisje heuristike që kanë potencialin për t'u zgjeruar dhe plotësuar me përmbajtje sistematike, krahasuese, empirike edhe pse ky artikull nuk pretendon të ofroj asgjë përtej një skice të thjeshtë të variacioneve të mundshme. Të dy llojet bazohen në shembuj nga Afrika sub-sahariane, nga njëra anë dhe Lindja e Mesme, Azia Jugore dhe Azia Lindore nga ana tjetër. Synimi im është të nënvizojë një vazhdimësi që varion nga format më pak bashkëpunuese të amvisërive që përfshijnë autonominë relative të njësisë nënë-fëmijë të evidentuar në poligjininë sub-sahariane, deri te entitetet më të përhapura të bashkëpunimeve me burrat në rajonet e identikuara nga Caldëell (1978) si "brezi patriarkal". Në pjesën e fundit, do të analizojë thyerjen dhe transformimin e pazareve patriarkale dhe ndërlidhjen e tyre me vetëdijen dhe betejat e grave.

#### AUTONOMI DHE PROTESTË:

#### DISA SHEMBUJ NGA AFRIKA SUB-SAHARIANE

Gjatë procesit të rishqyrtimit të literaturës mbi gratë në projektet e zhvillimit bujqësor në Afrikën sub-sahariane kam pasur një nga përvojat më të dëlira të shokut kulturor (Kandiyoti 1985). Meqë isha e familjarizuar me vetëm një lloj patriarkati (të cilin do ta

përshkruaj në disa detaje më vonë, nën rubrikën e patriarkatit klasik), nuk isha e përgatitur për atë që do të hasja. Literatura ishte e mbushur me raste të rezistencës së grave ndaj përpjekjeve për të ulur vlerën e punës së tyre dhe më e rëndësishmja, me raste të refuzimit të grave për të lejuar përvetësimin total të prodhimit të tyre nga burrat e tyre. Më lejoni të jap disa shembuj.

Kudo ku skemat e reja bujqësore i siguronin burrave të hyra dhe kredi dhe ku supozohej se si kryefamiljarë ata do të kishin qasje në punën e papaguar të grave të tyre, problemet dukej se ishin në sfond. Në vendbanimin e orizit të ujitur Mwea në Kenia, gratë privoheshin nga qasja në parcelat e tyre. Mungesa e alternativave dhe mungesa e plotë e kontrollit mbi të ardhurat e burrave të tyre e bënë jetën aq të papërbalueshme për gratë, sa që ato në masë të madhe braktisnin bashkëshortët e tyre (Hanger dhe Moris 1973). Në një skemë tjetër të rritjes së orizit, në Gambi, tokat e ujitura dhe kreditë ishin në dispozicion vetëm për burrat edhe pse ishin gratë ato që tradicionalisht kultivonin orizin në kënetat e baticës dhe ekzistonte një praktikë e gjatë që gratë dhe burrat që kultivonin të korrat e tyre dhe kishin bashkë kontrollë mbi produktin. Detyrat zakonore të grave sa i përket ndarjes së punës në parcela të përbashkëta dhe individuale i mbronin ato nga kërkesat e bashkëshortëve të tyre që të ofronin punë falas në fushat e ujitura me oriz që u përkisnin burrave. Burrat duhej t'iu paguanin rroga grave të tyre ose t'iu jepnin hua një parcelë të ujitur për të pasur qasje në punën e tyre. Në sezonin e shirave, kur gratë kishin alternativën e kultivimit të kënetës së tyre të orizit, ato krijuan një pengesë pune për burrat, të atillë që burrat thjesht duhej të prisnin ditët kur gratë nuk shkonin në fushat e tyre (Dey 1981).

Në rrëfimin e Contit (1979) për një projekt mbikëqyrës të vendbanimeve të pronarëve të vegjël në Voltën e Epërme ku ishin përsëri burrat ata që u pajisën me tokë dhe kredi, duke mos u lënë grave asnjë bazë të pavarur burimesh dhe një infrastrukturë shumë të papërshtatshme për të kryer punët e tyre të përditshme shtëpiake. Rezultati i saj ishte protesta e zëshme dhe refuzimi për të bashkëpunuar. Roberts ilustron në mënyrë të ngjashme strategjitë e përdorura nga gratë për të maksimizuar autonominë e tyre në kontekstin afrikan. Gratë yoruba në Nigeri, për shembull, negociojnë kushtet e shërbimeve të punës në fermë për burrat e tyre ndërsa synojnë t'i kushtojnë më shumë kohë dhe energji aktiviteteve tregtare që do t'u mundësojnë atyre të mbështesin veten dhe përfundimisht të heqin dorë nga shërbime të tilla. Gratë hausa, për shkak të izolimit

<sup>1</sup>prej islamit që bënë që kërkesat për punë nga burrat të jenë të reduktuara, e ndajnë punën e tyre për tregti, kryesisht në shitjen e produkteve ushqimore të gatshme.

Me pak fjalë, pasiguritë e poligjinisë<sup>2</sup> afrikane për gratë, përputhen me zonat e autonomisë relative që ato qartazi përpiqen t'i maksimizojnë. Përgjegjësia e burrave për mbështetjen e grave të tyre, ndonëse normative në disa raste, është në fakt relativisht e ulët. Zakonisht, është gruaja ajo që është kryesisht përgjegjëse për kujdesin ndaj vetës dhe të fëmijëve të saj, duke përfshirë këtu përballimin e kostove të arsimit të tyre, nganjëherë të asistuar nga burri i saj. Gratë kanë shumë pak çka të fitojnë dhe shumë për të humbur nëse bëhen plotësisht të varura nga burrat dhe për këtë arsye ato me të drejtë iu rezistojnë projekteve që rëndojnë mbi ekuilibrin delikat që ata përpiqen ta ruajnë. Në protestat e tyre, gratë janë duke i mbrojtur sferat ekzistuese të autonomisë së tyre.

Dokumentimi i një shkëmbimi të mirëfilltë midis autonomisë së grave dhe përgjegjësisë së burrave për gratë e tyre mund të gjinden në disa shembuj historik. Mann (1985) sugjeron se pavarësisht prej varësisë së gruas që shkaktohet nga martesja e krishterë, gratë yoruba në Lagos e kanë pranuar atë me entuziazëm për shkak të mbrojtjes më të madhe që kanë menduar se do të merrnin. Anasjelltas, burrat në Zambinë bashkëkohore i rezistojnë martesës më moderne, në krahasim me martesën e zakonshme sepse ajo i ngarkon ata me detyrime më të mëdha për gratë dhe fëmijët e tyre (Munachonga 1982). Një formë e bashkimit bashkëshortor në të cilën partnerët mund të negociojnë hapur shkëmbimin e shërbimeve seksuale dhe shërbimeve të punës, duket se shtron bazat për forma më të qarta të pazareve. Duke komentuar martesën Ashanti, Abu (1983, f. 156) tipari më i spikatur i së cilës duket të jetë "ndarja e burimeve dhe aktiviteteve të bashkëshortëve dhe haptazi elementi i pazarit në marrëdhënie". Poligjinia dhe në këtë rast, detyrimet e vazhdueshme të burrave dhe grave ndaj të afërmeve të tyre nuk nxisin nocionin e familjes ose familjes si një entitet bashkëpunues.

Vërehet dukshëm se ka ndryshime të rëndësishme në sistemet afrikane të fafesisnisë në lidhje me format e martesës, vendbanimit, prejardhjes dhe rregullat e trashëgimisë (Guyer dhe Peters 1987). Këto variacione bazohen në procese të plota kulturore dhe historike, duke përfshirë mënyra të ndryshme të përfshirjes së shoqërive afrikane në

---

<sup>1</sup> Shënim i përkthyesëve: Praktika e veçimit, në këtë rast të grave në sfera private

<sup>2</sup> Shënim i përkthyesëve: Praktika e martesave me shumë gra

ekonominë botërore (Mbilinyi 1982; Murray 1987; S. Young 1977. Megjithatë, është brenda një modeli të përcaktuar gjerësisht afro-karaibe që gjejmë disa nga rastet më të qarta të mosbashkëpunimit të familjes bashkëshortore si në ideologji ashtu edhe në praktikë, një fakt që ua informon grave strategjitë martesore dhe strategjitë e tregut të punës. Shkrimet mbi transformimet historike (për shembull, Etienne dhe Leacock 1980) sugjerojnë se kolonializmi gërryen bazën materiale për autonomi relative të grave (si për shembull qasja në përdorim dhe përfitim nga toka e përbashkët apo nga zejet tradicionale) pa ofruar masa zbutëse në treg apo opsione bashkëshortore. Projektet më bashkëkohore zhvillimore të diskutuara më lart gjithashtu priren ta marrin si të mirëqenë ose të imponojnë një model të familjes me një burrë në krye, i cili pakëson opsionet e grave pa ofruar rrugë të tjera drejt sigurisë dhe mirëqenies. Gratë i perceptojnë këto ndryshime, veçanërisht nëse ato ndodhin papritur, si shkelje të aranzhimeve të tyre ekzistente në raport me rendin e dominuar nga meshkujt . Si rrjedhojë, ato rezistojnë hapurazi.

#### NËNSHTRIMI DHE MANIPULIMI: GRATË NËN PATRIARKATIN KLASIK

Këta shembuj të rezistencës së hapur të grave janë në kontrast të plotë me përshtatjen e grave ndaj sistemit që unë do ta quaj si patriarkati klasik. Shembulli më i qartë i patriarkatit klasik mund të gjendet në një zonë gjeografike që përfshin Afrikën e Veriut, Lindjen e Mesme Muslimane (duke përfshirë Turqinë, Pakistanin dhe Iranin) dhe Azinë Jugore dhe Lindore (veçanërisht, Indinë dhe Kinën).\*

Çelësi i riprodhimit të patriarkatit klasik qëndron në funksionimin e familjes së zgjeruar patrilokale<sup>3</sup>, e cila gjithashtu zakonisht lidhet me riprodhimin e fshatarësisë në shoqëritë agrare (E. Wolf 1966). Edhe pse shumë kufizime siç janë kufizimet demografike mund të kenë kufizuar mbizotërimin numerik të familjeve patrilokale me tre breza, nuk ka dyshim se këto familje përfaqësojnë një ideal të fuqishëm kulturor. Mund të thuhet që urgjenca për të zgjeruar familjen patriarkale, e cila i jep burrave të moshuar por edhe burrave të rinjë, autoritet mbi të gjithë të tjerët, është e ndërlidhur me përfshirjen dhe kontrollin e familjes nga shteti (Ortner 1978) dhe me tranzicionin nga mënyrat e kontrollit të tepricës të bazuara në fafisni tek mënyrat tributare (E. Wolf 1982). Implikimet e kompleksitetit patrilineal-patrilokal për gratë jo vetëm që janë jashtëzakonisht uniforme por gjithashtu

---

<sup>3</sup> Shënim i përkthyesëve: Praktika që çiftet e martuara të jetojnë me apo afër familjes së bashkëshortit burrë

përfshijnë forma kontrolli dhe nënshtrimi që i kalojnë kufijtë kulturorë dhe fetarë, si ato të hinduizmit, konfucianizmit dhe islamit.

Nën patriarkatin klasik, vajzat martohen në një moshë shumë të re në familje të kryesuara nga babai i burrit të tyre. Në këto familje, ato iu nënshtrohen jo vetëm të gjithë burrave por edhe grave më të moshuara, veçanërisht vjehrrës së tyre. Shkalla në të cilën ky nënshtrim përfaqëson ndarje totale me familjen e tyre ndryshon bazuar në shkallën e endogamisë në praktikën martesore dhe konceptualizimet e aplikueshme të nderit. Mes turqëve, ka norma më të ulëta të endogamisë dhe në parim burri është përgjegjësi kryesor për nderin e gruas. Tek arabët, ka shumë më shumë reciprocitet mes familjeve dhe familja e gruas gëzon interes por edhe autoritet në ruajtjen e nderit të vajzës së tyre të martuar (Meeker 1976). Si rezultat, pozita tradicionale e një gruaje turke i ngjason më shumë statusit të "nuse-e huaj" tipike të Kinës para-revolucionare sesa asaj të një gruaje arabe, pozita e së cilës në familjen patriarkale mund të zbutet disi nga endogamia dhe afërsia e familjes së saj.

Pavarësisht nëse pagesa dominuese e martesës është prika apo çmimi për nuse, në patriarkatin klasik, gratë zakonisht nuk kanë ndonjë pretendim për trashëgiminë e babait të tyre. Prika e dhënë për to nuk kualifikohet si formë e trashëgimisë para vdekjes pasi ato transferohen drejtpërdrejt te të afërmit e dhëndrit dhe nuk marrin formën e pronës prodhuese, siç është toka (Agarwal 1987; Sharma 1980). Në komunitetet muslimane, për gratë të bërit presion për të drejtat e saj të trashëgimisë do të nënkuptonte humbjen e disa favoreve të vëllezërve të saj që janë streha e vetme në rast divorci apo keqtrajtimi të rëndë nga bashkëshorti i saj. Nusja e re hyn në shtëpinë e burrit si një individ i shpronësuar efektivisht e që mund të sigurojë trashëgimi vetëm duke prodhuar pasardhës meshkuj.

Kjo "linjë" e trashëgimisë e përvetëson plotësisht punën e grave dhe pasardhësit/et e saj si dhe e lë punën dhe kontributin e tyre në prodhim si të padukshëm. Cikli jetësor i gruas në familjen e zgjeruar patriarkale është i tillë që privimi dhe vështirësitë që ajo përjeton si një nuse e re, përfundimisht zëvendësohet nga kontrolli dhe autoriteti që ajo do të ketë mbi nuset tjera të reja. Natyra ciklike e autoritetit të grave në familje dhe pritshmëria e tyre për të trashëguar këtë autoritet nga gratë e moshuara inkurajon një përvetësim të plotë të kësaj forme patriarkati nga vetë gratë. Në patriarkatin klasik, nënshtrimi ndaj burrave kompensohet nga kontrolli që gratë e moshuara arrijnë mbi gratë më të reja. Megjithatë, gratë kanë qasje në vetëm një lloj të fuqisë punëtore që mund ta kontrollojnë dhe që mund t'iu ofrojë siguri në pleqërinë e tyre: atë të djemve

të tyre të martuar. Meqenëse djemtë janë burimi më qenësor i një nëne, sigurimi i besnikërisë së tyre gjatë gjithë jetës është një preokupim i qëndrueshëm. Gratë e moshuara kanë një interes të veçantë në shtypjen e dashurisë romantike midis të rinjve, për të mbajtur lidhjen bashkëshortore në nivel dytësor dhe për ta mbajtur besnikërinë të djemve ndaj tyre si kryesore. Gratë e reja kanë interes ta anashkalojnë dhe ndoshta t'i shmangen kontrollit të vjehrrës së tyre. Ka shembuj kulturalisht që janë specifike dhe tregojnë se si funksionon kjo luftë në dëm të lidhjes heteroseksuale (Boudhiba 1985; Johnson 1983; Mernissi 1975; M. Wolf 1972) por modeli i përgjithshëm është mjaft i ngjashëm.

Ndikimi i klasës ose i kastës në patriarkatin klasik krijon komplikime shtesë. Midis shtresave më të pasura, tërheqja e grave nga puna joshtëpiake është shpesh një shenjë e statusit të institucionalizuar në praktika të ndryshme të izolimit dhe përjashtimit, si sistemi i mbulesës ose i burkës. Institucioni i burkës dhe tregues të tjerë të ngjashëm të statusit, përforcojnë më tej varësinë e grave dhe varësinë e tyre ekonomike ndaj burrave. Megjithatë respektimi i praktikave kufizuese është një element kaq vendimtar në riprodhimin e statusit familjar, sa që gratë i rezistojnë shkeljes së rregullave edhe nëse respektimi i tyre prodhon vështirësi ekonomike. Ato heqin dorë nga opsionet ekonomikisht të favorshme të tilla si aktivitetet tregtare ku gratë janë të përfshira në një pjesë të Afrikës, për alternativa që perceptohen në përputhje me rolet e tyre të respektueshme dhe shtëpiake dhe kështu ato bëhen më të shfrytëzueshme. Në studimin e saj për prodhuesit e dantellave indiane në Narsapur, Mies (1982, f. 13) komenton:

Ndonëse shtëpiakizimi mund të përlijet nga format më të vjetra të izolimit, ajo tash ka ndryshuar karakterin e saj. Gratë Kapu nuk janë më *gosha* - gra të një kaste feudale luftëtare, por amvise dhe punëtore të mashtuara që prodhojnë për tregun botëror. Në rastin e dantellave, kjo ideologji është kthyer pothuajse në një forcë materiale. I gjithë sistemi është ndërtuar mbi ideologjinë se këto gra nuk mund të punojnë jashtë shtëpisë .

Kështu, ndryshe nga gratë në Afrikën Sub-sahariane që përpiqen t'i rezistojnë marrëdhënieve të pafavorshme të punës në familje, gratë në zonat e patriarkatit klasik shpesh u përmbahen rregullave, për aq kohë sa munden e që rezultojnë në zhvlerësimin e pandërprerë të punës së tyre. Luhatjet ciklike të pozitës së tyre në pushtet, të kombinuara me statusin e tyre, rezultojnë në një kontribim aktiv nga ana e tyre në riprodhimin e vetë shtypjes së tyre. Ato preferojnë të adaptojnë strategji ndërpersonale që maksimizojnë sigurinë e tyre përmes manipulimit të afeksionit të

djemve dhe bashkëshortit të tyre. Siç sugjeron diskutimi i thuktë i M. Wolf (1972) për familjen kineze, kjo strategji madje mund të rezultojë në humbjen e pushtetit nga burri patriarkal ndaj gruas së tij. Edhe pse këto taktika individuale për pushtet kontribuojnë pak për të ndryshuar kushtet strukturore të pafavorshme të skenarit të përgjithshëm patriarkal, gratë bëhen eksperte në maksimizimin e mundësive për jetën e tyre.

Duke komentuar "konservatorizmin femëror" në Kinë, Johnson (1983, f. 21) vëren: "Ironikisht, gratë përmes veprimeve të tyre për t'i rezistuar pasivitetit dhe kontrollit total të burrit, janë bërë pjesëmarrëse me interesa personale në sistemin që i shtypë ato." M. Wolf (1974) komenton në mënyrë të ngjashme rezistencën e grave kineze ndaj Ligjit të Martesës të vitit 1950, nga i cili ato supozohej të ishin përfitueset kryesore. Megjithatë, si përfundim ajo thotë që pavarësisht hezitimit të tyre për të transformuar plotësisht sistemin e vjetër të familjes, gratë kineze nuk do të jenë më të kënaqura me sigurinë e kufizuar që mund t'ua ofrojë manipulimi në marrëdhëniet familjare që ato bëjnë.

Në zonat tjera të patriarkatit klasik, ndryshimet e kushteve materiale kanë dëmtuar rëndë rendin normativ. Siç shprehet shkurt nga Cain et al. (1979, f. 410), çelësi dhe ironia e këtij sistemi qëndron në faktin se "autoriteti mashkullor ka një bazë materiale, ndërsa përgjegjësia mashkullore kontrollohet në mënyrë normative". Pothuajse një e treta e të vejave në fshatra ishin kryefamiljare, të cilat luftonin që të siguronin jetesën përmes punës me pagë. Megjithatë, ndarja e tregut të punës u krijua dhe u forcua nga patriarkati që nënkuptonte se mundësitë e tyre për punë ishin jashtëzakonisht të kufizuara dhe ato duhej të pranonin paga shumë të ulëta dhe të pasigurta.

Në mënyrë paradoksale, rreziqet dhe pasiguritë ndaj të cilave ekspozohen gratë në patriarkatin klasik, krijojnë një nxitje të fuqishme për fertilitet më të lartë gjë që në kushtet e thellimit të varfërisë, e bënë edhe më të vështirë gjetjen e një strehe ekonomike. Greeley (1983) gjithashtu dokumenton rritjen e varësisë së familjeve në Bangladesh që janë pa tokë, në punën e paguar të grave, duke përfshirë atë të grave të martuara dhe diskuton mënyrat në të cilat stabiliteti i familjes patriarkale minohet. Diskutimi i Stacey (1983) për krizën në familjen kineze para revolucionit, përbën një përshkrim klasik të erozionit të themeleve materiale dhe ideologjike të sistemit tradicional. Ajo vazhdon të eksplorojë sesi patriarkati konfucian u zëvendësua dhe u shndërrua në forma të reja demokratike dhe socialiste. Në pjesën tjetër, unë do të analizoj disa nga implikimet e proceseve të tilla të transformimit.



## SHKATËRRIMI I PAZAREVE PATRIARKALE: ZMBRAPSJE NË KONSERVATIZIM APO PROTESTË RADIKALE?

Bazat materiale të patriarkatit klasik shkatërrohen nën ndikimin e forcave të reja të tregut, depërtimit të kapitalit në zonat rurale (Kandiyoti 1984) ose proceseve të varfërimit kronik. Përderisa nuk ka asnjë rrugë të vetme që çonë në prishjen e këtij sistemi, pasojat e tij janë mjaft uniforme. Dominimi i burrave të rinj nga burrat e moshuar dhe strehimi i grave në sferën shtëpiake ishin shenjat dalluese të një sistemi në të cilin burrat kontrollonin një formë të qëndrueshme të trashëgimisë së përbashkët si tokë, kafshë ose kapital tregtar. Mes atyre që nuk kanë pronë dhe të shpronësuarve, domosdoshmëria e kontributit të çdo anëtari të familjes për mbijetesë e kthen mbrojtjen ekonomike të grave në një mit.

Prishja e patriarkatit klasik rezulton në emancipimin e hershëm të të rinjve nga baballarët e tyre dhe ndarjen e tyre të hershme nga familja. Përderisa ky proces nënkupton që gratë do t'i shpëtojnë kontrollit të vjehrrave dhe të kryesojnë familjet e tyre në një moshë shumë më të re, kjo do të thotë gjithashtu se ato vetë nuk mund të presin një të ardhme të rrethuar nga nuset e nënshtruara. Për gratë që e gjejnë veten në mes të këtyre dy gjeneratave, ky transformim mund të përfaqësojë një tragjedi të vërtetë personale, pasi ato kanë paguar çmimin e rëndë të një ujdje të mëparshme patriarkale por nuk janë në gjendje të përfitojnë nga përfitimet e premtuara. Statistikat e M. Wolf (1975) mbi vetëvrasjen e grave në Kinë tregojnë një ndryshim të qartë në nga vitet 1930, me një rritje të mprehtë të shkallës së vetëvrasjeve të grave mbi 45 vjeç, teksa më parë normat ishin më të lartat tek gratë e reja, veçanërisht nuset e reja. Ajo e lidhë këtë ndryshim në mënyrë të drejtpërdrejt me emancipimin e djemve dhe mundësinë e tyre të re për t'i shpëtuar kontrollit familjar në zgjedhjen e bashkëshortes së tyre, gjë që i grabitë gruas së moshuar fuqinë dhe respektin e saj si vjehërr. Pavarësisht pengesave që patriarkati klasik iu vendosë grave që mund të peshojë më shumë se çdo siguri aktuale ekonomike dhe emocionale, gratë shpesh i rezistojnë procesit të tranzicionit sepse shohin se rendi i vjetër normativ u largohet atyre pa ndonjë alternativë fuqizuese. Në një diskutim më të gjerë të interesit të grave, Molyneux (1985, fq. 234) vëren se:

*Kjo nuk është vetëm për shkak të "vetëdijes së rreme" siç supozohet shpesh - edhe pse kjo mund të jetë një faktor - por sepse ndryshime të tilla të realizuara pjesë-pjesë mund të kërcënojnë interesat praktike afatshkurtra të disa grave ose të sjellin një kosto në humbjen e formave të mbrojtjes që më pas, në një farë menyrë nuk kompensohen fare.*

Kështu, kur patriarkati klasik hyn në një krizë, shumë gra mund të vazhdojnë të përdorin të gjithë presionin që mund të bëjnë për t'i bërë burrat të përmbushin detyrimet e tyre dhe nuk do të bëjnë kompromisë me bazën e pretendimeve të tyre, përveçse nën presionin më ekstrem, duke dalë kështu jashtë linjës dhe duke humbur respektin e tyre. Rezistenca pasive e tyre e merr formën e shfrytëzimit të mbrojtjes specifike që pazari patriarkal ofron në këmbim të nënshtrimit të tyre dhe përshtatjes brenda sistemit.

Përgjigja e shumë grave që në këtë kontekst duhet të punojnë për paga, mund të jetë një rritje e përdorimit të shënjesve tradicionalë të modestisë, siç është mbulesa. Shpesh, pa asnjë zgjedhje të tyre, ato janë duke punuar jashtë shtëpisë së tyre dhe kështu "eksponohen"; tani ato duhet të përdorin çdo mjet simbolik që kanë në dispozicion për të lënë të nënkuptuar se vazhdojnë të jenë të denja për mbrojtje. Është domethënëse që nxitjet e Khomeinit për t'i mbajtur gratë në shtëpi, gjetën mbështetje entuziaste në mesin e shumë grave iraniane pavarësisht elementeve të dukshme të shtypjes. Premtimi për rritjen e përgjegjësisë mashkullore rikthen integritetin e marrëveshjes së tyre origjinale patriarkale në një mjedis ku gama e opsioneve në dispozicion të grave është jashtëzakonisht e kufizuar. Gratë më të reja përvetësojnë mbulesën, siç thotë Azari (1983, f. 68), sepse "kufizimi i vendosur ndaj tyre nga një urdhër islamik, ishte një çmim i vogël që duhej paguar në këmbim të sigurisë, stabilitetit dhe respektit të premtuar nga ky urdhër".

Kjo analizë e konservatorizmit femëror si një reagim ndaj prishjes së patriarkatit klasik nuk shterron aspak gamën e përgjigjeve të mundshme në dispozicion të grave. Ajo thjesht synon t'i tregojë vendin një strategjie të caktuar brenda logjikës së brendshme të një sistemi të caktuar, paralele këto të cilat mund të gjenden në kontekste shumë të ndryshme, siç janë shoqëritë e industrializuara të Evropës Perëndimore dhe Shteteve të Bashkuara. Analizat historike dhe bashkëkohore të transformimit të fakteve dhe ideologjive të familjeve perëndimore nënkuptojnë ndryshime në pazaret patriarkale. Studimi i Gordon (1982) për ndryshimin e qëndrimeve feministe ndaj kontrollit të lindjes në shekujt XIX dhe XX, përshkruan strategjinë e amësisë vullnetare si pjesë e një llogaritjeje më të gjerë për të përmirësuar situatën e grave. Analiza e Cott (1978) mbi ideologjinë së mungesës së pasionit midis grave viktoriane tregon gjithashtu natyrën strategjike të zgjedhjeve të grave.

Për epokën moderne, Ehrenreich (1983) ofron një analizë të prishjes së pazarit patriarkal të klasës së mesme të bardhë në Shtetet e Bashkuara. Ajo gjurmon largimin progresiv të burrave nga roli i familjes, duke filluar nga vitet 1950 dhe sugjeron se kërkesat e grave

për autonomi më të madhe erdhën në një kohë kur përgjegjësia bashkëshortore e burrave ishte zvogëluar dukshëm tashmë dhe alternativat për burrat jashtë lidhjes bashkëshortore kishin fituar legjitimitet të konsiderueshëm kulturor. Pavarësisht mobilizimit intensiv ideologjik që përfshin ekspertë të tillë si mjekë, këshilltarë dhe psikologë, të cilët u përpoqën të përforconin idenë e burrit si kryefamiljar dhe gruas si shtëpiake, tendencat alternative filluan të shfaqen dhe të sfidojnë rendin normativ dominues. Në këtë sfond, Ehrenreich vlerëson lëvizjet feministe dhe anti-feministe dhe thotë: "Duket sikur, duke u përballur me pasigurinë shekullore të sistemit të pagave familjare, gratë zgjedhën strategji të kundërta: ose të dilnin (duke folur në mënyrë figurative) dhe të luftonin për barazi, të ardhura dhe mundësi ose të qëndronin në shtëpi dhe të përpiqesh t'i lidhnin burrat më fort për to" (1983, p. 151). Prandaj, familjarizmi i lëvizjes anti-feministe mund të interpretohet si një përpjekje për të rivendosur një marrëveshje më të vjetër patriarkale, me feministet që përdoren si kurbane të cilave ua hedhin fajin për pakënaqësinë dhe tjetërsimin që aktualisht është ndër burra (Chafetz dhe Dëorkin 1987). Në të vërtetë, Stacey (1987, f. 11) sugjeron se "feminizmi shërben si një rrufe simbolike për nostalgjinë e përhapur dhe dëshirën për intimitetin dhe sigurinë e humbur që aktualisht përshkon kulturën sociale dhe politike në Shtetet e Bashkuara".

Megjithatë, format e vetëdijes dhe të luftës që shfaqen në kohërat e ndryshimeve të shpejta shoqërore, kërkojnë shqyrtim dashamirës dhe mendjehapur, në vend të kategorizimeve të nxituara. Kështu, Ginsburg (1984) e vlerëson aktivizmin kundër abortit tek gratë në Shtetet e Bashkuara si strategjik dhe jo domosdoshmërisht reaksionar. Ajo thekson se shkëputja e seksualitetit nga riprodhimi dhe sfera shtëpiake prej shumë grave perceptohet si armiqësore ndaj vetë interesave të tyre, pasi, ndër të tjera, ajo dobëson presionin shoqëror ndaj burrave për të marrë përgjegjësinë për pasojat riprodhuese të aktivitetit seksual. Ky shqetësim dhe ankthi i përgjithshëm që shprehet nuk janë aspak të pabaza (English, 1984) dhe i japin zë mungesës aktuale të alternativave të qëndrueshme për mbështetjen emocionale dhe materiale të grave me fëmijë. Ngjashëm, Stacey (1987) identifikon forma të ndryshme të vetëdijes "post-feministe" të epokës post-industriale. Ajo sugjeron se për momentin një shkrirje kontradiktore dhe komplekse mes ideve të feministeve të depolitizuara kundrejt punës dhe familjes dhe strategjive personale të grave për rritur stabilitetin dhe intimitetin në martesë është duke ndodhur.

Në nivelin ideologjik, pazaret e prishura duket se nxisin një kërkim të fajtorëve, një dëshirë për t'i rikthyer siguritë e një rendi më tradicional ose një ndjenjë se ndryshimi mund të ketë shkuar ose shumë larg ose shumë keq. Reflektimet e Rosenfelt dhe të Stacey-t (1987) mbi post-feminizmin dhe diskutimin e Stacey-t (1986) mbi feminizmin pro-familjes, ndonëse i kritikojnë premisat alarmuese të diskursit neokonservator, i marrin seriozisht disa nga shqetësimet që ai i shpërfaqë.

## PËRFUNDIM

Analizat sistematike të strategjive dhe mekanizmave të rezistencës së grave mund të ndihmojnë për të kapur natyrën e sistemeve patriarkale në kontekstin e tyre kulturor, kohor dhe specifik klasor dhe të zbulojnë se si burrat dhe gratë rezistojnë, përshtaten dhe bien ndesh me njëri-tjetrin mbi burimet, të drejtat dhe përgjegjësitë. Analiza të tilla shpërbëjnë disa nga ndarjet artificiale të dukshme në diskutimet teorike të marrëdhënieve ndërmjet klasës, racës dhe gjinisë, pasi strategjitë e pjesëmarrësve/eve janë të formësuara nga disa sërë kufizimesh. Gratë luajnë me strategjitë e tyre gjithmonë sipas kontekstit të pazareve të identifikueshme patriarkale që veprojnë si shkrime të thjeshta që përcaktojnë, kufizojnë dhe ndikojnë në tregun e tyre dhe opsionet e brendshme. Dy sistemet ideale tipike të dominimit mashkullor të diskutuara në këtë artikull ofrojnë baza të ndryshme nga të cilat gratë negociojnë dhe kanë strategji që secila ndikon në format dhe potencialet e rezistencës dhe betejave të tyre. Pazaret patriarkale nuk informojnë thjesht zgjedhjet racionale të grave por ato formësojnë aspektet më të pavetëdijshme të subjektivitetit gjinor, pasi ato përshkojnë kontekstin e socializimit të tyre të hershëm si dhe mjedisin kulturor të tyre (Kandiyoti 1987a, 1987b).

Një fokus në pazaret patriarkale më ngushtësisht të definuara ofron prespektiva më të mira për analizë më të detajuar të proceseve të transformimit sesa një një nocion i pakualifikuar i patriarkatit. Në analizën e saj të ndryshimeve në imazhet seksuale dhe zakonet në shoqëritë perëndimore, Janeway (1980) huazon terminologjinë e paradigmeve shkencore të Thomas Kuhn (1970). Ajo sugjeron, për analogji, se idetë dhe praktikat e përbashkëta gjerësisht në fushën e seksualitetit mund të veprojnë si paradigma seksuale, duke vendosur rregullat e normalitetit në çdo kohë të caktuar por edhe të prekshme ndaj ndryshimit kur "rregullat ekzistuese nuk funksionojnë, kur

anomalitë nuk mund të të shmanget më gjatë, kur bota reale e përvojës së përditshme sfidon kauzalitetin e pranuar" (1980, f. 582). Megjithatë, paradigmat seksuale nuk mund të kuptohen plotësisht nëse ato nuk përfshihen në rregullat e pazareve patriarkale të përcaktuara në mënyrë më specifike, siç tregon vetë Janeway në diskutimin e saj për lidhjen midis idealit të dëlirësisë femërore në shoqëritë perëndimore dhe dhe kalimi i pasurisë tek trashëgimtarët e ligjshëm përpara ardhjes së një ekonomie të përgjithësuar të parasë.

Për ta shtrirë edhe më tej analogjinë kuhniare, pazaret patriarkale tregojnë se ka një fazë normale dhe një fazë krize, një koncept që modifikon vetë interpretimin tonë të asaj që po ndodh në botë. Kështu, gjatë fazës normale të patriarkatit klasik, kishte një numër të madh të grave që në fakt ishin të ekspozuara ndaj pasigurisë dhe vështirësive ekonomike. Ato ishin infertile dhe duhej të divorcoheshin ose jetime dhe pa mbështetje dhe të pambrojtura sepse nuk kishin djem të mbijetuar ose - edhe më keq - kishin djem "mosmirënjohës". Megjithatë, ato konsideroheshin thjesht "pa fat", anomali dhe viktime aksidentale të një sistemi që kishte kuptim ndryshe. Është vetëm në pikën e prishjes që çdo urdhër zbulon kontradiktat e tij sistematike. Ndikimi i transformimeve bashkëkohore socio-ekonomike mbi martesën dhe divorcin, formimin e familjes dhe në ndarjen gjinore të punës çonë në mënyrë të pashmangshme në vënien në pikëpyetje të supozimeve themelore, të nënkuptuara pas marrëveshjeve midis grave dhe burrave.

Megjithatë, strategjitë dhe format e reja të vetëdijes nuk dalin thjesht nga rrënojat e së vjetrës që prodhojnë pa probleme një konsensus të ri por krijohen përmes betejave personale dhe politike, të cilat shpesh janë komplekse dhe kontradiktore (shih Strathern 1987). Prishja e një sistemi të caktuar patriarkal, në afat të shkurtër, mund të gjenerojë raste të rezistencës pasive midis grave që marrin formën paradoksale të ofertave për rritjen e përgjegjësisë dhe kontrollit nga ana e burrave. Të kuptuarit më mirë i strategjive afatshkurtra dhe afatmesme të grave në vende të ndryshme shoqërore mund të ofrojë një ndikim në korrigjimin e përkufizimeve etnocentrike ose klasore të asaj që përbën një ndërgjegje feministe.

## SHËNIME

1. Ashtu si të gjithë termat e krijuar për të përcjellë një koncept kompleks, termi pazarllëk patriarkal përfaqëson një kompromis të vështirë. Ai synon të tregojë ekzistencën e rregullave të përcaktuara dhe skenarë që rregullojnë marrëdhëniet gjinore, me të cilat të dyja gjinitë përshtaten dhe pajtohen që megjithatë mund të

kontestohen, ripërcaktohen dhe rinegociohen. Disa alternativa të sugjeruara ishin termat *kontratë*, *marrëveshje* ose *skenar*; megjithatë, asnjë nga këto nuk e kapi plotësisht rrjedhshmërinë dhe tensionin e nënkuptuar nga pazari. Unë jam mirënjohës për Cynthia Cockburn dhe Nels Johnson që theksuan se termi pazar zakonisht tregon një marrëveshje midis pjesëmarrësve pak a shumë të barabartë, kështu që nuk zbatohet saktësisht për përdorimin tim, gjë që tregon qartë një shkëmbim asimetrik. Megjithatë, gratë si rregull bëjnë pazare nga një pozitë më e dobët.

2. Unë po përjashtoj jo vetëm Azinë Juglindore, por edhe Mesdheun Verior, pavarësisht ngjashmërive të rëndësishme në këtë të fundit në lidhje me kodet e nderit dhe rëndësinë e përgjithshme që i kushtohet pastërtisë seksuale të grave, sepse dua të kufizoj veten në zonat ku dominon kompleksi patrilokal-patrilinial. Kështu, shoqëritë me sisteme dypalëshe farefisnore, si Greqia, në të cilat gratë trashëgojnë dhe kontrollojnë pronën dhe marrin prikë që përbëjnë pronë prodhuese, nuk janë të kualifikueshme pavarësisht ngjashmërive të rëndësishme në aspekte të tjera ideologjike. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se ekziston një homogjenitet i pakualifikuar i ideologjisë dhe praktikës brenda kufijve gjeografikë të treguar. Për shembull, ka variacione kritike brenda nënkontinentit Indian që kanë implikime dukshëm të ndryshme për gratë (Dyson dhe Moore 1983). Anasjelltas, edhe në fushat e farefisnisë dypalëshe, mund të ketë raste në të cilat të gjitha aspektet e patriarkatit klasik, domethënë, prona, vendbanimi dhe prejardhja përmes linjës mashkullore, mund të bashkohen në rrethana të caktuara (Denich 1974). Ajo që po sugjeroj është që shembujt më të qartë dhe lehtësisht të identifikueshëm të patriarkatit klasik mund të gjenden brenda kufijve të treguar në tekst.

## REFERENCAT

Abu, K. 1983. "Ndarja e bashkëshortëve: Burimet bashkëshortore në një qytet në Ashanti. Fq. 156-68. Pp. 156-68 në *Femrat dhe Meshkujt në Afrikën Perëndimore*, redaktuar nga C. Oppong. Londër: George Allen & Unëin.

Aganual, B. 1987. "Gratë dhe të Drejtat e Tokës në Indi". Dorëshkrim i pabotuar.

Azari, F. 1983. "Apeli i Islamit për Gratë në Iran: Iluzioni dhe realiteti". Fq. 1-71 në *Gratë e Iranit: Konflikti me Islamin Fundamentalist*, redaktuar nga F. Azari. Londër: Ithaca Press.

Barrett, M. 1980. *Shtypja e grave sot*. Londër: Verso.

Beechey, V. 1979. "Mbi Patriarkatin". *Rishikimi Feminist* 3:66-82.

Boudhiba, A. 1985. *Seksualiteti në Islam*. Londër: Routledge & Kegan Paul.

Cain, M., S. R. Khanan dhe S. Nahar. 1979. "Klasa, Patriarkati dhe Puna e Grave në Bangladesh". *Rishikimi i Popullsisë dhe Zhvillimit* 5:408-16

Caldëell, J. C. 1978. "Një Teori e Fertilitetit: Nga Rafshnalta e lartë te Destabilizimi". *Rishikimi i Popullsisë dhe Zhvillimit* 4:553-77

Chafetz, J. S. dhe A. G. Dëorkin. 1987 "Përballë Kërcënimit: Anti Feminizmi i Organizuar në Perspektivë Krahasuese". *Gjinia & Shoqëria* 1:33-60.

Conti, A. 1979. "Organizimi kapitalist i prodhimit nëpërmjet marrëdhënieve jo-kapitaliste: Roli i grave në një projekt pilot risistemimi në Voltën e Epërme". *Rishikimi i Ekonomisë Politike Afrikane* 15/16:75-91

Delphy, C. 1977. *Armiku kryesor*. Londër: Qendra e Kërkimeve dhe Burimeve të Grave.

Denich, B. S. 1974. "Pushteti Seksand në Ballkan". Fq. 243-62 në *Gratë, Kultura dhe Shoqëria*, redaktuar nga M. 2. Rosaldo dhe L. Lamphere. Palo Alto, CA: Stanford University Press.

Dey, J. 1981. "Gratë Gambiane: Partnerë të Pabarabartë në Projektet e Zhvillimit të Orizit". Fq. 109-22 në *Gratë afrikane në procesin e zhvillimit*, redaktuar nga N. Nelson. Londër: Frank Cass

Dyson, T. dhe M. Moore. 1983. "Për strukturat e fafëfisnisë, autonominë e gruas dhe sjelljen demografike". *Rishikimi i Popullsisë dhe Zhvillimit* 9:35-60.

Ehrenreich, B. 1983. *Zemrat e burrave*. Londër: Pluto Press.

Eisenstein, Z. 1978. "Zhvillimi i një teorie të patriarkatit kapitalist dhe feminizmit socialist". Fq. 5-40 në *Patriarkati Kapitalist dhe Çështja për Feminizmin Socialist*, redaktuar nga Z. Eisenstein. Nju Jork: Shtypi i Rishikimit Mujor.

Anglisht, D. 1984. "Frika se feminizmi do t'i lirojë së pari burrat". Fq. 97-102 në *Fuqitë e Dëshirës: Politikat e Seksualitetit*, redaktuar nga A. Snitoe, C. Stansell dhe S. Thompson. Nju Jork: Shtypi i Rishikimit Mujor

Etienne, M. dhe E. Leacock (eds.). 1980. *Gratë dhe kolonizimi*. Nju Jork: Praeger.  
Ginsburg, F. 1984. "Trupi politik: Mbrojtja e Kufizimit seksual nga Aktivistët Kundër Abortit". Fq. 173-88 në *Kënaqësi dhe Rrezik: Duke Ekploruar Seksualitetin Femror*, redaktuar nga C. S. Vance. Londër: Routledge & Kegan Paul

Gordon, L. 1982. "Pse Feministët e Shekullit të Nëntëmbëdhjetë nuk e Mbështetën (kontrollin e lindjeve) dhe Feministët e Shekullit të Njëzetë e Mbështetën: feminizmi, riprodhimi dhe familja". Fq. 40-53 në *Rimendimi i familjes: Disa pyetje feministe*, redaktuar nga B. Thome dhe M. Yalom. Nju Jork: Longman.

Greeley, M. 1983. "Patriarkati dhe Varfëria: Një Rast Studimi i Bangladeshit". *Kërkimet e Azisë Jugore* 335-55.

Guyer, J. I. dhe P. E. Peters. 1987. "Hyrje" në konceptimin e familjes: çështje të Teorisë dhe Politikës në Afrikë." *Zhvillimi dhe Ndryshimi* 18:197-213

Hanger, J. dhe J. Moris. 1973. "Gratë dhe ekonomia shtëpiake". Fq. 209-44 në *Mëea: Një Vendbanim i Ujitur i Orizit në Kenia*, redaktuar nga R. Chambers dhe J. Morris. Mynih: Welt Forum Verlag.

Hartmann, H. 1981. "Martesa e Pakënaqur e Marksizmit dhe Feminizmit: Drejt një Bashkimi më Progresiv". Fq. 40-53 në *Gratë dhe Revolucioni*, redaktuar nga L. Sargent. Londër: Pluto Press.

Janeway, E. 1980. "Kush është Sylvia? Për humbjen e paradigmave seksuale." *Signs: Gazeta e Grave në Kulturë dhe Shoqëri* 5:573-89.

Johnson, K. A. 1983. *Gratë, Revolucioni i Familjes dhe Fshatarëve në Kinë*. Chicago: Chicago University Press.



Kandiyoti, D. 1984. "Transformimi rural në Turqi dhe Implikimet e tij për Studimet e Grave". Fq. 17-29 në *Gratë në lëvizje: Transformimet Bashkëkohore në Familje dhe Shoqëri*. Paris: UNESCO.

1985. *Gratë në sistemet e prodhimit rural: problemet dhe politikat*. Paris: UNESCO

1987a. "Të emancipuar por të paçliruar? Reflektime mbi rastin turk". Studime Feministe 13317-38. --A. 1987b.

1987b. "Problemi i Subjektivitetit në Teorinë Feministe Perëndimore." Punim i paraqitur në Takimin Vjetor të Shoqatës Sociologjike Amerikane, Çikago.

Kuhn, T. 1970. *Struktura e Revolucioneve Shkencore (Botimi 2)*. Çikago: Chicago University Press.

Mann, K. 1985. *Martesa e mirë: Martesa, Statusi dhe Ndryshimi Social Mes Elitës së Arsimuar në Lagosin Kolonial*. Kembrixh: Cambridge University Press.

Mbilinyi, M.J. 1982 "Gruaja, Skllavëria dhe Subjekti i Mbretit : Shtypja e grave në Mbretërinë Shambala." Shënime dhe regjistrime të Tanzanisë 88/89:1-13

McDonough, R. dhe R. Harrison. 1978. "Patriarkati dhe Marrëdhëniet e Prodhimit". Fq. 11-41 në *Feminizmin dhe Materializmin*, redaktuar nga A. Kuhn dhe A. M. Wolpe. Londër: Routledge & Kegan Paul

Meeker, M. 1976. "Kuptimi dhe shoqëria në Lindjen e Afërt: Shembuj nga Turqit e Detit të Zi dhe Arabët Levantinë." *Gazeta Ndërkombëtare e Studimeve të Lindjes së Mesme* 7:383-422

Mernissi, F. 1975. *Përtej Shamisët: Dinamika Burrë-Grua në një shoqëri muslimane*. Nju Jork: Wiley.

Mies, M. 1982. "Dinamika e Ndarjes Seksuale të Punës dhe Integrimi i Grave në Tregun Botëror". Fq. 1-28 në *Gratë dhe Zhvillimi: Ndarja seksuale e Punës në Shoqëritë Rurale*, redaktuar nga L. Beneria. Nju Jork: Praeger

1986. *Patriarkati dhe Akumulimi në një Shkallë Botërore: Gratë në Divizioni Ndërkombëtar i Punës*. Londër: Zed.

Mitchell, J. 1973. *Pasuri e grave*. Nju Jork: Vintage

1986. "Reflektime mbi Njëzet Vjet Feminizëm". Fq. 34-48 në *Çfarë është Feminizmi?* redaktuar nga J. Mitchell dhe A. Oakley. Oxford: Basil Blackëell.

Molyneux, M. 1985. "Mobilizimi Pa Emancipim? Interesat e Grave, Shteti dhe Revolucioni në Nikaragua". *Studime Feministe* 11:227-54

Muchinga, M. L. 1982. "Ndarja e të Ardhurave dhe Administrimi i Opsioneve në Zambinë Urbane: Gratë kundrejt të Farëfisit të gjeruar". Punim i paraqitur në Konferencën mbi Gratë dhe Kontrollin e të Ardhurave në Botën e Tretë, Nju Jork.

Murray, C. 1987. "Klasa, Gjinia dhe Familja: Cikli i Zhvillimit në Afrikën Jugore". *Zhvillimi dhe Ndryshimi* 18:235-50

Ortner, S. 1978. "Virgjëresha dhe Shteti". *Studime Feministe* 4:19-36

Roberts, P. Në vazhdim. "Gratë rurale në Nigerinë Perëndimore dhe Hausa Niger: Një Analizë Krahasuese", në shërbim të dy pronarëve, redaktuar nga K. Young. Neë Delhi: Allied Publishers

Rosenfelt, D. dhe J. Stacey. 1987. "Mendimet e dyta mbi Valën e Dytë". *Studime Feministe* 13:341-61.

Sharma, U. 1980. *Gratë, Puna dhe Prona në Indinë Veriperëndimore*. Londër: Tavistock

Stacey, J. 1983. *Patriarkati dhe Revolucioni Socialist në Kinë*. Berkeley: Shtypi i Universitetit të Kalifornisë.

1986. "A Kanë Frikë Feministët të Largohen nga Shtëpia? Sfidat e Feminizmit Konservator pro-familjes." Fq. 219-48 në *Çfarë është Feminizmi?* redaktuar nga J. Mitchell dhe A. Oakley. Oxford: Basil Blackëell

1987 "Seksizmi me Një Emër më Delikat? Kushtet Postindustriale dhe Ndërgjegjja Postfeministe në Silicon Valley." *Rishikimi Socialist (Nëntor)*: 7-28.

Strathern, M. 1987. "Një raport i sikletshëm: Rasti i Feminizmit dhe Antropologjisë." Shenjat: REvista e Grave në Kulturë dhe Shoqëri. Wolf, E. 1966. Peasants. Englewood Cliffs, NJ: Prentice-Hall.

1982. *Evropa dhe Njerëzit pa Histori*. Berkeley: Universiteti i Shtypit të Kalifornisë

Wolf, M. 1972. *Gratë dhe Familja në Tajvanin Rural*. Palo Alto, CA: Stanford University Press.

1974. "Gratë kineze: Aftësitë e Vjetra në një Kontekst të ri". Fq. 157-72 në *Gratë, Kultura dhe Shoqëria*, redaktuar nga M. 2. Rosaldo dhe L. Lamphere. Palo Alto, CA: Stanford University Press.

1975. "Gruaja dhe vetëvraska në Kinë." Fq. 111-41 në *Gratë në Shoqërinë Kineze*, redaktuar nga M. Wolf dhe R. Witke. Palo Alto, CA: Stanford University Press.

Young, I. 1981. "Përtej Martesës së Palumtur: Një Kritikë e Teorisë së Sistemeve të Dyfishta". Fq. 43-69 në *Gratë dhe Revolucioni*, redaktuar nga L. Sargent. Londër: Pluto Press.

Young, S. 1977. "Fertiliteti dhe Uria: Historia Bujqësore e Grave në Mozambikun jugor". Fq. 66-81 në *Rrënjët e Varfërisë Rurale në Afrikën Qendrore dhe Jugore*, redaktuar nga R. Palmer dhe N. Parsons. Londër: Heinemann.

\*Deniz Kandiyoti, *Lektore e Lartë në Divizionin e Shkencave Sociale, Kolegji Richmond, Surrey, Angli, dha mësim dhe bëri kërkime në Turqi nga viti 1969 deri në 1980. Hulumtimet dhe publikimet e saj janë në fushat e zhvillimit dhe grave, grave në Lindjen e Mesme dhe teorisë feministe*



KOLEKTIVI PËR MENDIM DHE VEPRIM  
FEMINIST

Prishtinë, gusht, 2022